



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 345/ prot.

Tiranë, më 05.05.2023

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 345/2, DATË 20.04.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASJA ZNJ. REFIJE BRAHIMAJ NË LIDHJE ME VEPRIMTARINË E ISH MAGJISTRATIT Z. P.V. DHE ARKIVIMIN PAS VERIFIKIMIT TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA SHTETASJA ZNJ. REFIJE BRAHIMAJ, NË LIDHJE ME VEPRIMTARINË E MAGJISTRATEVE ZNJ. M.I., Z. S.P., ZNJ. A.Z. DHE ZNJ. A.S.”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e znj. Refije Brahimaj me nr. 2863 prot., datë 24.11.2020, nr. 1139 prot., datë 19.02.2021 ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve znj. M.I., z. P.V z. S.P., znj. A.Z. dhe znj. A.S., gjyqtarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe me vendimin nr. 345/2, datë 20.04.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për përfundimin e procedurës së arkivimit pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasja znj. Refije Brahimaj në lidhje me veprimtarinë e ish magjistratit z. P.V. dhe arkivimin pas verifikimit të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasja znj. Refije Brahimaj, në lidhje me veprimtarinë e magjistratëve znj. M.I., z. S.P., znj. A.Z. dhe znj. A.S.”, bazuar në nenet 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, 122, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendim duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Sarandë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Lagjia nr. 4, Rruga: “Mitat Hoxha”, Nr. 1;

- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

